



Shërbimi i mjekut të shkollës

Letër dërguar prindërve dhe kujdestarëve ligjore për fëmijët e ardhshëm të vitit 1 të kopshtit

Ekzaminim parandalues nga mjeku i shkollës

Të dashur prindër dhe kujdestarë ligjorë

Pas pushimeve verore të ardhshme, fëmija juaj hyn në kopsht. Për këtë hap të madh në jetën e saj/tij, i urojmë asaj/atij një fillim të mirë dhe eksperiencë pozitive.

Ekzaminime parandaluese për mbrojtjen e shëndetit

Shërbimi i mjekut të shkollës mbështet shëndetin e të gjithë fëmijëve të shkollës fillore nga kopshtet deri në nivelin dytësor. Aktualisht, rregullorja e shkollës fillore parashikon tre ekzaminime parandaluese të detyrueshme nga mjeku i shkollës. Qëllimi i këtyre ekzaminimeve është që të zbulohen në kohë rreziqet për zhvillimin dhe shëndetin e fëmijëve, në mënyrë që të merren në kohë masat e përshtatshme, nëse është e nevojshme. Në këtë mënyrë, për çdo fëmijë duhet të krijohen kushte sa më shumë të përshtatshme për të pasur një kohë të mirë në shkollë.

Kryerja e ekzaminimit parandalues nga mjeku i shkollës pranë pediatri privat ose pranë mjekut të familjes në kuadër të kontrollit 4 vjeçar; konfirmimi i shërbimit të mjekut të shkollës

Ekzaminimi parandalues nga mjeku i shkollës bëhet në nivelin e kopshtit. Rregullorja kantonale e shkollës fillore parashikon që ky ekzaminim nga mjeku i shkollës, si pjesë e kontrollit të zakonshëm 4 vjeçar, të kryhet nga pediatri privat/mjeku i familjes së fëmijës. Ekzaminimi përfshin kontrollin e aftësisë pamore dhe dëgjimore, gjatësinë dhe peshën, kontrollin e gjendjes së vaksinimit dhe një vlerësim të zhvillimit.

Kryerja e ekzaminimit parandalues nga mjeku i shkollës duhet të konfirmohet pranë shërbimit të mjekut të shkollës deri më 31 dhjetor të vitit të parë të kopshtit. Në mënyrë ideale, merreni me vete formularin e konfirmimit (ngjyrë portokalli) direkt në kontrollin 4 vjeçar nga pediatria/pediatri juaj.

Të dhëna jo të detyrueshme në formularin e konfirmimit

▶ **Bashkëngjitje e kopjes së kartës së vaksinimit**

Nëse shpërthen në shkollë një sëmundje infektive ngjitëse, si p. sh. lija e ujit ose meningjiti me qelb, Shërbimi Mjekësor Kantonal përputhet me masat e shërbimit nga mjeku i shkollës për të parandaluar përhapjen e këtyre sëmundjeve. Në mënyrë që



masat e nevojshme të mund të zbatohen me një humbje kohe sa më të vogël, është shumë e rëndësishme që vaksinimi i fëmijëve të shkollës të jetë i njohur në momentin e shfaqjes së sëmundjes.

Prandaj ju lutemi të na vini në dispozicion një kopje të kartës së vaksinimit ose të dokumentoni vaksinimin në formularin e konfirmimit (ngjyrë portokalli) nga ana e mjekes/mjekut tuaj.

► **Trendet e shëndetit**

Për ne është e rëndësishme që të përshtatim ofertat e ardhshme për mbështetjen e shëndetit me nevojat aktuale të fëmijëve të shkollës. Prandaj rezultatet e ekzaminimit parandalues nga mjeku i shkollës i vlerësojmë në mënyrë anonime; dhe në këtë mënyrë, jemi në gjendje të përcaktojmë trendet e shëndetit të fëmijëve të shkollës së qytetit të Cyrihut. Ju mund të na mbështetni në këtë angazhim të rëndësishëm duke na vënë në dispozicion rezultatet e ekzaminimit nëpërmjet formularit të konfirmimit, bashkëngjitur.

Në rast se mungon konfirmimi deri më 31 tetor

Nëse shërbimi i mjekut të shkollës së qytetit Cyrih nuk merr një konfirmim deri më 31 tetor të vitit të 1-rë të kopshtit, ne do ta ftojme fëmijën tuaj në klinikën e mjekut të shkollës. Atëherë ekzaminimi tek mjeku i shkollës bëhet nga ne, megjithatë jo me të njëjtin diapazon si kontrolli 4 vjeçar i pediatrit.

Pyetje?

Përgjigjet ndaj pyetjeve që bëhen më shpesh (FAQ) i gjeni në

www.stadt-zuerich.ch/vorsorgeuntersuchung-kindergarten

Për informacione të mëtejshme mund t'i drejtoheni në çdo kohë mjekes/mjekut tuaj të shkollës. Adresën e gjeni në krye të letrës ose në internet në www.stadt-zuerich.ch/schularzt



Për informacion:

Dokumentet për regjistrimi në kopsht dërgohen/janë dërguar në shkurt nga ana e autoriteteve të shkollës së qarkut.

I urojmë fëmijës suaj një kohë sa më të shëndetshme në kopsht dhe shkollë dhe ju përshëndesim miqësisht.

Shërbimi juaj i mjekut të shkollës